

REAGIM në MEDIA

Thirrje Këshillit Bashkiak, Durres për miratimin e Buxhetit 2011

Zyra e Transparencës Qytetare Durres, mbështetur nga Qendra ÇIP, shpreh sot publikisht shqetesimin për vonesat serioze në miratimin e buxhetit të Bashkisë së Durrësit për vitin 2011. Edhe pse zgjedhjet lokale kanë përfunduar në 8 maj, Durresi sot akoma nuk ka buxhetin e tij. Për më tepër, akoma nuk është caktuar një datë se kur do të miratohet buxheti nga Këshilli i ri bashkiak, nderkohe që mbeten më pak se kater muaj nga mbyllja e këtij viti.

Miratimi i buxhet është përgjegjësi dhe detyrim ligjor për Këshillin Bashkiak. Këshilli Bashkiak i Durrësit nuk duhet të humbasë asnjë minutë më tepër për të kryer detyrën e tij paresore si parlament i qytetit, qe eshte pikerisht kalimi i buxhetit.

Zyra e Transparencës Qytetare Durrës i kërkon gjithashtu Këshillit Bashkiak që, gjatë procesit të miratimit të buxhetit, të mos anashkalojë asnjë prej hapave të diskutimit të tij, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me thithjen mendimit të publikut. Qyteti ka nevojë për investime, ndërkohë që edhe qytetarët duhet të informohen se ku shkojnë dhe si përdoren taksat që ata paguajnë.

Buxheti përbën elementin më të rëndësishëm në përpjekjet e gjithë banorëve të Durrësit, qofshin këta pushtetarë lokalë apo njëerëz të thjeshtë, për të patur një qytet më të mirë, shërbime publike më të mira, mundësi më të gjëra për zhvillimin e tij ekonomik, mjedis më të pastër, etj. Kandidatët në zgjedhjet e 8 majit premtuan një qytet më të mirë, dhe qytetarët durrësak votuan pikërisht për një qytet më të mirë. Buxheti është mjeti që i ben keto premtime te prekshme. Pa buxhet ato jane thjesht premtime ne ere.

Pikërisht për këtë, Zyra e Transparencës Qytetare, Durrës i kujton Këshillit Bashkiak përgjegjësinë e madhe që ka para qytetarëve të vet. Ne kerkojme sot qe draft buxheti t'i shpendahet sa më parë palëve të interesuar që keto të kenë mundësi efektive të njohjes më draftin. Po kështu, në kërkojnë publikimin e draft buxhetit në faqen zyrtare të bashkisë së Durrësit, në mënyrë që jo vetëm palët e interesuara, por dhe të gjithë qytetarët të kenë mundësi efektive të njohjes me të.

Zyra e Transparencës Qytetare, Durres, është krijuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik, me seli në Tiranë. Aktualisht ZTQ mbështetet nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C (e cila financohet kryesisht nga Kongresi Amerikan). Misioni i Zyrës së Transparencës Qytetare është të promovojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrjen e Këshillit Bashkiak. Nën kujdesin e Qendrës ÇIP, ZTQ Durres do të monitorojë të gjitha modalitetet e vendimarrjes në Këshillin Bashkiak.